



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.2.2025

Nr: 145

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA DEMOKRATIKE”,  
ME KRYETAR Z. SALI BERISHA, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR  
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1130 Prot., datë 19.2.2025, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia Demokratike”, me kryetar Z. Sali Berisha.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Demokratike” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

“Partia Demokratike” nëpërmjet Kryetarit Z. Sali Berisha, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 28.01.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Demokratike”, me inicial “ PD ose PDSH”, me Kryetar Z. Sali Berisha, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

Data: 24.2.2025 Nr: 145  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokratike”, me kryetar Z. Sali Berisha, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Demokratike” me shkronja nistore “ PD ose PDSH ”, me adresë: Bulevardi "Zhan D'ark", Nr.11, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Sali Berisha , me adresë: Rruga "Mustafa Matohiti", Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Etleva Selimaj, me adresë: Bulevardi "Zhan D'ark", Nr.11, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Franci Nuri dhe Z. Marash Logu me adresë Bulevardi "Zhan D'ark", Nr.11, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Demokratike”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Demokratike”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

### **V E N D O S :**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike”, me kryetar Z. Sali Berisha, me shkronjat nistore “PD ose PDSH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**